

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	<b>Z. Lubomir Mariq Ministër i Pushtetit Lokal</b>	<b>DATE DATUM DATE</b>	<b>13.01.2016</b>
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	<b>Ismajl Kurteshi, deputet i Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!</b>		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	<b>Pyetje Parlamentare (përgjigje me shkrim)</b>		

Në bazë të Rregullës 46 e Rregullores së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigjeje me shkrim:


**ÇËSHTJA:** Strukturat Paralele të Serbisë,

**PYETJE PARLAMENTARE:** Z. Ministër,

Strukturat paralele në Kosovë jo vetëm se nuk po zhbëhen, e as nuk po reduktohen por ato edhe po shtohen. Me 25 dhjetor të vitit 2015 Marko Gjuriq e ka emëruar Goran Stojkoviqin koordinator të Qeverisë së Serbisë për Gjilanin, Vitin, Dardanën dhe Artanën. Stojkoviq zyrën e ka hapë në Kllokot.

Çka keni ndërmarr ju si ministër i pushtetit lokal që ta pengoni këti agresioni administrativ të Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës?





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	Ministra lokalne vlasti, gospodin Ljubomira Marića	<b>DATE DATUM DATE</b>	13.01.2016
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Ismajl Kurteši, poslanik PG Pokreta "Samoopredeljenje"		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Poslaničko pitanje (za pismeni odgovor)		

Shodno članu 46 Poslovnika Skupštine Kosova, postavljam pitanje za pismeni odgovor:


**Pitanje:** Paralelne strukture Srbije,

**Parlamentarno pitanje:** gospodine ministar,

Paralelne strukture Srbije na Kosovu, ne samo da se ne ugase i ne smanjuju, već se i dalje množe. Naime, 25. decembra 2015. godine Marko Đurić imenovao je Gorana Stojkovića za koordinatoravlade Srbije za Gnjilane, Vitinu, i Kamenicu sa kancelarijom u Klokotu.

- *Šta ste, kao ministar lokalne vlasti, preduzeli da sprečite administrativnu agresiju Srbije unutar teritorije Republike Kosova?*





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	<b>Z. Isa Mustafa Kryeministër në Qeverinë e Kosovës.</b>	<b>DATE DATUM DATE</b>	<b>13.01.2016</b>
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	<b>Ismajl Kurteshi, deputet i Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!</b> / Kurteshi		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	<b>Pyetje Parlamentare (përgjigje me shkrim)</b>		

Në bazë të Rregullës 46 e Rregullores së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigjeje me shkrim:


**ÇËSHTJA:** Strukturat Paralele

**PYETJE PARLAMENTARE:** Z. Kryeministër,

Strukturat paralele në Kosovë jo vetëm se nuk po zhbëhen, e as nuk po reduktohen por ato edhe po shtohen. Me 25 dhjetor të vitit 2015 Marko Gjuriq e ka emëruar Goran Stojkoviçin koordinator të Qeverisë së Serbisë për Gjilanin, Vitin, Dardanën dhe Artanën. Stojkoviç zyrën e ka hapë në Klllokot.

Si e arsyetoni heshtjen e Qeverisë që ju e drejtoni, asnjë reagim, asnjë përpjekje për ta penguar një gjë të tillë, sikur këto që po ndodhin këtu të ndodhshin në një vend të huaj. Edhe pas këti agresioni administrativ të Serbisë ju e keni konfirmuar shkuarjen në Bruksel për të vazhduar me “normalizimin” e marrëdhënieve me Serbinë.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	<b>Z. Arban Abrashi</b> <b>Ministër për punë dhe çështje</b> <b>sociale</b>	<b>DATE</b> <b>DATUM</b> <b>DATE</b>	<b>13.01.2016</b>
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	<b>Ismajl Kurteshi, deputet i Grupit Parlamentar të Lëvizjes</b> <b>VETËVENDOSJE!</b> <i>I. Kurteshi</i>		
<b>SUBJEKTI</b> <b>PREDMET</b> <b>SUBJECT</b>	<b>Pyetje Parlamentare (përgjigje me me shkrim)</b>		

Në bazë të Rregullës 46 e Rregullores së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigjeje me shkrim:


**ÇËSHTJA:** Punësimi

**PYETJE PARLAMENTARE:** Z. Ministër,

Me 26 dhjetor të vitit 2015 keni deklaruar se gjatë vitit 2015 në Kosovë janë hapur 15.539 vende të reja pune.

Kërkojë nga ju zotëri ministër të më informoni ku saktësisht janë hapur ato vende të reja pune?





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	<b>Z. Arban Abrashi</b> <b>Ministër i Ministrisë së Punës</b> <b>dhe Mirëqenies Sociale</b>	<b>DATE</b> <b>DATUM</b> <b>DATE</b>	<b>18.01.2016</b>
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	<b>Ismajl Kurteshi, deputet i Grupit</b> <b>VETËVENDOSJE!</b> <i>I. Kurteshi</i>	<b>Parlamentar të Lëvizjes</b>	
<b>SUBJEKTI</b> <b>PREDMET</b> <b>SUBJECT</b>	<b>Pyetje Parlamentare (përgjigje me shkrim)</b>		

Në bazë të Rregullës 46 e Rregullores së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigjeje me shkrim:

**ÇËSHTJA:** Pensionet e punëtorëve që janë pensionuar në Zvicrës

**PYETJE PARLAMENTARE:** Z. Ministër, në shtator të vitit të kaluar keni deklaruar (premtuar) se çështja e pensionistëve të pensionuar në Zvicër do të rregullohet brenda një viti (në tetor 2015).

Ju lutem më njoftoni ku ka arritur ky proces dhe kur do të finalizohet?





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	<b>Z. Arsim Bajrami</b> <b>Ministër i MASHT-it</b>	<b>DATE</b> <b>DATUM</b> <b>DATE</b>	<b>18.01.2016</b>
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	<b>Ismajl Kurteshi, deputet i Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!</b> <i>I. Kurteshi</i>		
<b>SUBJEKTI</b> <b>PREDMET</b> <b>SUBJECT</b>	<b>Pyetje Parlamentare (përgjigje me shkrim)</b>		


Në bazë të Rregullës 46 e Rregullores së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigjeje me shkrim:

**ÇËSHTJA:** Regjistrimi në kolegjet private

**PYETJE PARLAMENTARE:** Z. Ministër, jemi në pjesën e dytë të janarit. Viti akademik ka filluar para tre muaj e gjysme, semestri i parë ka përfunduar, megjithatë kolegjet ende përmes mjeteve të informimit po thërrasin student të ri të regjistrohen. Ndaj kësaj shkelje të madhe ministria që ju e drejtoni po heshtë. Z. Ministër kjo dukuri e shëmtuar nuk paraqet shkelje të ligjit vetëm për kolegjet por edhe për MASHT-in dhe ju personalisht.

Z. Ministër pse nuk po e pengoni këtë shkelje serioze të ligjit?





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	<b>Z. Arsim Bajrami</b> <b>Ministër i MASHT-it</b>	<b>DATE</b> <b>DATUM</b> <b>DATE</b>	<b>25.01.2016</b>
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Ismajl Kurteshi, deputet i Grupit Parlamentar të Lëvizjes <b>VETËVENDOSJE!</b> <i>I. Kurteshi</i>		
<b>SUBJEKTI</b> <b>PREDMET</b> <b>SUBJECT</b>	Pyetje Parlamentare (përgjigje me shkrim)		

Në bazë të Rregullës 46 e Rregullores së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigjeje me shkrim:


**ÇËSHTJA:** Reciprociteti

**PYETJE PARLAMENTARE:** Z. Ministër, Vendimin tuaj për reciprocitet në lidhje me tekstet shkollore në mesë të Kosovës dhe Serbisë e ka thye kërkesa e sekretarit të MKRS datë 16. 09. 2015 drejtuar Drejtorit të Doganave të Kosovës dhe kërkesa e sekretarit të MASHT-it i cili ka kërkuar nga Dogana e Kosovës që t'i lirojë pajisjet laboratorike për Fakultetin ilegal të Shkencave Teknike në pjesën veriore të Mitrovicës.

Tekstet shkollore për nxënësit shqiptar të Luginës së Preshevës ende po qëndrojnë të bllokuara.

Z. Ministër, kush i ka autorizuar sekretarët e dy ministrive ta shkelin vendimin tuaj politik dhe qka keni ndërmarr ju në lidhje me këtë skandal?





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	<b>Z. Kujtim Shala Ministër i MKRS</b>	<b>DATE DATUM DATE</b>	<b>25.01.2016</b>
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	<b>Ismajl Kurteshi, deputet i Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!</b> <i>I. Kurteshi</i>		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	<b>Pyetje Parlamentare (përgjigje me shkrim)</b>		

Në bazë të Rregullës 46 e Rregullores së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigjeje me shkrim:

**ÇËSHTJA:** Reciprociteti

**PYETJE PARLAMENTARE:** Z. Ministër, ju me siguri jeni i informuar për vendimin e Ministrit të MASHT-it në lidhje me reciprocitetin në segmentin e këmbimit të teksteve shkollore me Republikën e Serbisë dhe kushtëzimin e lejimit të teksteve nga Serbia me lejimin e teksteve nga Kosova për nxënësit shqiptar të Luginës së Preshevës të cilat autoritetet serbe i kanë bllokuar që nga shtatori i vitit 2015.

Për çudi sekretari i MKRS-së, z. Veton Firzi, me 16. 10. 2016 ka kërkuar nga drejtori i Doganave të Kosovës t'i lejoj tekstet shkollore nga Serbia të futen në Kosovë dhe kështu e ka shkel vendimin politik të një ministrie tjetër.

Z. Ministër, si është e mundur që sekretari i MRSK-së të ndërhyj në punët e MASHT-it dhe ta thyejnë vendim politik të saj?





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly



<b>PËR / ZA / TO</b>	<b>Z. Hajredin Kuçi Ministër i Drejtësisë</b>	<b>DATE DATUM DATE</b>	<b>02.02.2016</b>
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	<b>Ismajl Kurteshi, deputet i Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!</b>		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	<b>Pyetje Parlamentare (përgjigje me shkrim)</b>		

Në bazë të Rregullës 46 e Rregullores së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigjeje me shkrim:

**ÇËSHTJA:** Marrëveshja e 25 gushtit

**PYETJE PARLAMENTARE:** Z. Ministër, Kryeministri i Kosovës, edhe pas aktvendimit të Gjykatës Kushtetuese që ka konstatuar shpërputhje (lexo shkelje) të Kushtetutës, po insiston në mos ndryshimin e Marrëveshjes për Asociacionin e komunave me shumicë serbe. Cili është komenti i juaj karshi qëndrimit të Kryeministrit? Nëse e vlerësoni të drejt qëndrimin e tij ju lutem argumentojë. Kësaj Shkrese unë po ja bashkangjes një analizë që unë ja kam bërë aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, Miqve të Gjykatës D.S. dhe k. I. Si dhe gjykatësit B. S.

- **Pse nuk mund të korrigjohen shkeljet kushtetuese pa tërheqjen e Parimeve?**

1. **Rëndësia e Parimeve në krijimin e Asociacionit, bazuar në përgjigjen e Gjykatës Kushtetuese, gjykatësit Bekim Sejdiu, Miqve të Gjykatës Kushtrim Istrefi dhe Dastid Pallaska:**

Në pikën 104/ faqe 18/, të përgjigjes së Gjykatës Kushtetuese, në pyetjen e Presidentes së Republikës së Kosovës, (më tutje pika):

*Gjykata konsideron se, çështjet e ngritura në kërkesën e tanishme (që kanë të bëjnë me parimet) janë të një rëndësie të madhe dhe relevante për rendin kushtetues të Kosovës.*



Në pikën 105/ faqe 19/, thuhet: ... Parashtruesja e pyetjes pohon se *Parimet do të kenë efekt juridik* në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës, *përmes akteve juridike pasuese që miratohen në bazë të Parimeve.*

Në pikën 108/ faqe 19/ **Gjykata gjen se çështjet e dorëzuara nga parashtruesja janë të natyrës kushtetuese. Ato kanë për qëllim të sigurojnë që themeli i Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe është në pajtim me shkronjën dhe me frymën e Kushtetutës.**

*Po të mos ishin të rëndësishme parimet atëherë me siguri pyetja e Presidentes nuk do të bëhej pikërisht në lidhje me përputhshmërinë e Parimeve me Kushtetutën.*

**Pyetja e Presidentes, drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me parimet e Asociacionit është si në vijim:**

**”Duke marrë parasysh se Parimet e Asociacionit rregullojnë krijimin dhe funksionimin e Asociacionit..., a janë në përputhshmëri këto parime dhe elementet me frymën e Kushtetutës...?”**

**Në lidhje me rëndësinë e Parimeve: Parashtruesja (Presidentja), në (pikën 86/ faqe 15) argumenton:**

**Parimet e Asociacionit, në formën e një akti juridik të miratuar nga Kryeministri, rregullojnë çështjet që hyjnë në gamën e çështjeve që prekin frymën e Kushtetutës... .. zbatimi i detyrimeve të Parimeve të Asociacionit prodhon efekt juridik, në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës.**

*Kryeministri nuk e ka kundërshtuar as pyetjen as argumentimin e Presidentes, në lidhje me rëndësinë e Parimeve dhe efektin juridik të tyre, në sistemin kushtetues të vendit, por po kundërshton t’i tërheq Parimet.*

**Gjykata Kushtetuese, përkitazi me pyetjen e Presidentes, konstaton si në vijim: Parimet, siç janë elaboruar në “Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë – Parimet e përgjithshme /Elementet kryesore” nuk janë tërësisht në përputhshmëri me frymën e Kushtetutës, me nenin 3, kapitullin II dhe me kapitullin III, të Kushtetutës.” (faqe 39).**

## **2. Pa ndryshim të parimeve nuk ka korrigjim të shkeljeve të Kushtetues**

Në pikën 118/ faqe 21/ thuhet: **Statuti ... duhet të bazohet në kornizën e përcaktuar në kapitujt e parimeve, si një akt juridik i Qeverisë së Kosovës.**

Pika 117/ faqe 20/ shpjegon se: **Sipas parimit 21, Statuti do të përgatitet nga një organ tjetër... .**

**Efektet e Parimeve në rendin kushtetues, sipas gjyqtarit Bekim Sejdiu në rastin KO 136/15. /faqe 15/**



“...Parimet e Asociacionit, si një akt ligjor, prodhojnë efekte të konsiderueshme për rendin kushtetues të Republikës së Kosovës. ...zbatimi i plot i Parimeve të Asociacionit brenda kuadrit të rendit kushtetues të Kosovës do të përbënte një anomali kushtetuese. Për rrjedhojë... **ose duhet të ndryshohet Kushtetuta ose duhet të ndryshohen dhe riformulohen Parimet** e asociacionit (së bashku me legjislacionin zbatues) që të jenë në pajtim me Kushtetutën.

### 3. Dekreti buron nga Parimet e Asociacionit /faqe 5/ (B. S.)

- Dekreti është vetëm një akt zbatues që buron nga Parimet e Asociacionit;
- Dekreti nuk mund të ndryshojë Parimet e Asociacionit;
- Vetëm dekreti do të shqyrtohet drejtpërdrejt nga gjykata.

### 4. Dallimi në mesë të Marrëveshjes së parë dhe Parimeve të 25 gushtit:

Në Pikën 130/faqe 23/ të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese thuhet se: Pika 3 e Marrëveshjes së parë (prill 2013) përcakton se **”struktura e Asociacionit do të themelohet mbi të njëjtën bazë sikurse statuti ekzistues i Asociacionit të Komunave të Kosovës...”**

Miku i Gjykatës Kushtetuese (K. I.), të cilin e ka konsultuar Gjykata, në pikën 49/faqe 9/ prezanton **Dallimet në mesë të marrëveshjes së parë, të vitit 2013, dhe marrëveshjes së 25 gushtit 2015** (parimet e Përgjithshme), në lidhje me dallimet në mes të dy marrëveshjeve të lartë përmendura ai konstaton:

Për dallim nga Parimet e Përgjithshme, Marrëveshja e parë nuk e definon Asociacionin si një “entitet ligjor” të “karakterit të veçantë”; nuk e parasheh themelimin e tij me dekret të Qeverisë; nuk specifikon burimet, buxhetin, administratën dhe kompetencat që përmbajnë parimet e përgjithshme. Në vend të kësaj, Marrëveshja e parë parasheh se kompetencat e asociacionit do të ushtrohen në pajtueshmëri me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, dhe se strukturat e Asociacionit do të formohen në të njëjtën bazë me statutin ekzistues të Asociacionit të komunave të Kosovës.

*Kurse sipas Gjykatësit të Gjykatës Kushtetuese Bekim Sejdiu Elementet shtesë në Marrëveshjen e 25 gushtit në krahasim me marrëveshjen e parë janë:*

*Komunat nuk kanë të drejt të largohen nga Asociacioni (paragrafi 17 i Parimeve të Asociacionit).*

*Stafi i Asociacionit “përfiton nga ligji për shërbyesit civil.*

*Parimet e Asociacionit përcaktojnë se Asociacioni ka të drejt t’i ketë në bashkëpronësi kompanitë që ofrojnë shërbime lokale... .*



### ***Marrëveshja e parë kundërkushtetuese***

Në pikën 148/ faqe 27/ ... Gjykata konsideron se aktet juridike dhe statuti i Asociacionit nuk duhet të zëvendësojnë ose minojnë statutin e komunave...

Në pikën 153/ faqe 30/ Gjykata konstaton se në marrëveshjen e parë, shkelet e drejta për gjasa të barabarta në punësim në strukturën e Asociacionit, kurse në marrëveshjen e parë parashihet punësim vetëm për serbet, edhe pse në disa nga këto komuna jetojnë pjesëtar të komuniteteve të tjera, në përqindje të konsiderueshme.

### ***Dykuptimësia në përkthim***

Sipas (K. I.), Pika 44/ **...frazja e përdorur** në pikën 4 të parimeve të përgjithshme, "ushtron vështrim të plot" (exercise full overvieë), nuk mund të gjendet në literaturën juridike...

Në pikën 143, 144/ faqe 26/ Ka dykuptimësia në përkthimin e marrëveshjes. Formulimet në marrëveshjen për Asociacionit ndryshojnë nga ato të Marrëveshjes së parë"

### **5. Objektivat e Asociacionit/Bashkësisë**

Në pikën 138/ faqe 24/. Gjykata vëren se objektivat e Asociacionit, kanë për qëllim qeverisjen lokale dhe organizimin territorial... këto objektiva janë kundër kushtetuese.

### **6. Shërbyesit Civil Pika 157/ faqe 30/**

Gjykata rikujton se neni 101 i Kushtetutës, hyn në kapitullin VI, (Qeveria e Republikës së Kosovës) prandaj shërbyesit civil janë të punësuarit në organet qeveritare, kurse Qeveria ushtron pushtet ekzekutiv. Në pikën 159/faqe 31/ **Gjykata konkludon se stafi i administratës së Asociacionit nuk duhet të konsiderohet pjesë e shërbimit civil.** Në pikën 160, Gjykata këtë çështje e konsideron kundër kushtetuese.

Sipas (D. P.) pikë 73/faqe 13/ ...dhënia e statusit të shërbyesve civil për të punësuarit e Asociacionit është në kundërshtim me nenin 101 të Kushtetutës...

### **7. Marrëdhëniet e Asociacionit me autoritetet qendrore janë kundër kushtetuese**

Në pikën 166/faqe 33/ Gjykata konstaton se marrëdhëniet e Asociacionit me autoritetet qendrore të parapara në marrëveshje janë kundër kushtetuese.

### ***Ekskluziviteti etnik i Asociacionit është kundër kushtetues***

Gjykata gjen se Asociacioni nuk mund të vishet me autoritetet të plot dhe ekskluziv për të promovuar interesat e komunitetit serb të Kosovës në marrëdhëniet e saj me autoritetet qendrore. Në pikën 177, kushtetuesja këtë kapitull e vlerëson si kundërkushtetues.



**Faqe 12/ Parimet e Asociacionit janë të papajtueshme me parimin e shumë etnisë dhe të mos diskriminimit. (B. S.)**

**8. Parimet për kapacitetet ligjore kundër kushtetues**

Në pikën 136/ faqe 23/. ...**Gjykata konsideron se Parimet e përcaktuara në kapitullin mbi kornizën ligjore janë në shpërputhje me Kushtetutën...**

Në pikën 185/faqe 37/ Gjykata gjen se: Parimet për kapacitetet ligjore, buxhetin dhe përkrahjen si dhe dispozitat e përgjithshme dhe përfundimtare janë kundër kushtetuese.

Sipas gjykatësit të Gjykatës Kushtetuese Bekim Sejdiu, Parimet e Asociacionit bien në kundërshtim me parimet më themelore të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. (B. S.) faqe 10

**Pjesë nga Parashtesa e mikut të Gjykatës, Dastid Pallaska.** (Gjykata Kushtetuese e ka kërkuar mendimin e z. Pallaska)

Sipas shpjegimit të (D. P.) në pikën 61/faqe 11/ ...kategoria e përkatësisë etnike... nuk mund të jetë interes i përbashkët i komunave...

Sipas shpjegimit në pikën 64 të (D. P.) “ ... ofrimi i funksioneve dhe shërbimeve publike nga Asociacioni, siç parashihet me nenin 4 të Parimeve të Përgjithshme përbën shkelje të drejtpërdrejt të nenit 123 të Kushtetutës...” . “(pika 65) neni 4 e përcakton Asociacionin si njësi shtesë të vetëqeverisjes lokale mbi komunat”.

Në pikën 67/faqe 12/ (D. S.) shpjegon:” ...me nenin 5 të parimeve të Përgjithshme i cili parasheh se Asociacioni do të ushtrojë edhe kompetenca shtesë, të cilat mund të delegohen nga autoritetet qendrore, shkel nenet 123 dhe 124 të Kushtetutës”.

Pika 68/ ...neni 79 i Kushtetutës nuk e njeh Asociacionin si një palë që mund të ndërmerr iniciativa legjislative. Rrjedhimisht mund të konkludohet se neni 10 i Parimeve të Përgjithshme paraqet shkelje të drejtpërdrejt të nenit 79 të Kushtetutës...

**9. Territori, gjyqtarit Bekim Sejdiu në rastin KO130/15./faqe 7/**

Sipas (B. S. ) Krijimi i Asociacionit nuk mund t'i nënshtrohet regjimeve juridike të bazuara në territor.

**Në Faqen 13 (B. S.) shpjegon:” dy përbërësit themelor të Parimeve të Asociacionit Parimi etnik dhe ai gjeografik, prodhojnë një realitet të ri juridik në Kosovë”. Rrjedhimisht përbërësit e lartpërmendur janë antikushtetues.**

**10. Karta Evropiane /8/**



*Sipas Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale bazë e asocimit nuk mund të jetë interesi i grupeve të veçanta brenda komunave.*

Sipas Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale, bazë e bashkëpunimit dhe asocimit mund të jetë interesi i përbashkët i komunave – jo interesi i grupeve të veçanta brenda komunave, (si parashihet në Parimet e Asociacionit të komunave me shumicë serbe që merret vetëm me interesat e komunitetit serb).

*Sipas Kartës Evropiane Asociacioni i komunave duhet të formohet nga vetë komunat dhe jo nga autoritetet qendrore.*

**11. Elementet që i japin Parimeve të Asociacionit tipare të një njësie të veçantë të vetëqeverisjes të veshura me funksione ekzekutive:**

**Faqe 11/** Parimet e Asociacionit parashikojnë krijimin e Asociacionit me shumë elemente dhe tipare të një njësie të veçantë të vetëqeverisjes, me kompetenca ekzekutive, ndryshe nga Asociacioni i komunave të Kosovës.

Sipas Gjykatës Kushtetuese: Zbatimi i “funksioneve publike” është atribut i organeve qeveritare.

Miku i Gjykatës (D. P.) në Pikën /69/ shpjegon: “ ...fakti se Parimet e përgjithshme kërkojnë transferim ose ndarjen e disa funksioneve kryesore komunale me Asociacionin dëshmon se Asociacioni paraqet një organizatë me kompetenca ekzekutive e që është një njësi shtesë e vetëqeverisjes lokale, më e lart se komuna...” .

Bazuar në vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarit Bekim Sejdiu dhe dy miqve të Gjykatës: z. Dastid Pallaska dhe z. Kushtrim Istrefi del se:


1. Pyetja e Presidentes së Kosovës është bërë pikërisht për Parimet e Asociacionit, pasi që Parimet janë bazë mbi të cilën ndërtohet Asociacioni.
2. Qeveria e Kosovës nuk ka pas vërejtje në materien e pyetjes së Presidentes dhe është zotuar publikisht se do ta respekton vendimin e Kushtetutës.
3. Bazë për hartimin e Statuti janë Parimet e Asociacionit.
4. Sa i përket Parimeve Gjykata ka konstatuar se Parimet e Përgjithshme (elementet kryesore) nuk janë tërësisht në përputhje me frymën e Kushtetutës.
5. Rrjedhimisht për ta hartuar statutin në përputhje me Kushtetutën duhet të tërheqim Parimet e nënshkruara me 25 gusht në Bruksel nga Kryeministri i Kosovës.
6. Parimet e Asociacionit prodhojnë efekte për rendin kushtetues të Kosovës, prandaj ose duhet të ndryshohet Kushtetuta ose duhet të ndryshohen parimet e Asociacionit.
7. Dekreti buron nga Parimet e Asociacionit, prandaj përmes dekretit nuk mund të mënjanojen shkeljet kushtetuese si që po aludon Kryeministri.



8. Ekzistojnë dallime substanciale në mes të Marrëveshjes së parë, të nënshkruar në prill të vitit 2013 nga Kryeministri i atëhershëm H. Thaçi dhe marrëveshjes së gushtit 2015 të nënshkruar nga Kryeministri I. Mustafa.
9. Edhe Marrëveshja e Parë ka elemente antikushtetuese.
10. Problem të veçantë paraqet dykuptimësia e përkthimit të Marrëveshjes.
11. Bazuar në Parimet ekzistuese, Asociacioni synon të ushtroj kompetenca ekzekutive dhe të ketë organizim territorial.
12. Kompetencat ekzekutive dhe organizimi i Asociacionit i bazuar në territor janë antikushtetues
13. Marrëdhëniet horizontale të Asociacionit me Institucionet Qendrore, e drejta në pronë dhe shërbyesit civil janë attribute të njësive federale brenda një shteti federativ, por jo edhe të Asociacioneve.
14. Ekskluziviteti etnik është antikushtetues dhe racist.
15. Parimet për kapacitetet ligjore janë antikushtetuese.
16. Parimet e Asociacionit janë në shpërputhje me Kartën Evropiane Për administratën lokale.
17. Asociacioni i komunave me shumicë serbe duhet të ketë statut identik me atë të Asociacionit të komunave të Kosovës.
18. Bazuar në argumentet e lartpërmendura tërheqja e Marrëveshjes së 25 gushtit 2015 në lidhje me Parimet mbi Asociacionin/Bashkësinë e Komunave me shumicë serbe është e pa alternativ si që është e pa alternativ edhe dorëheqja e Qeverisë së Kosovës e cila e ka shkel Kushtetutën e vendit.

Ismajl Kurteshi, janar 2016





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly

<b>PËR/ZA/TO</b>	<b>Znj. Hykmete Bajrami</b> <b>Ministreshë e Tregtisë dhe</b> <b>Industrië</b>	<b>DATE</b> <b>DATUM</b> <b>DATE</b>	<b>02.02.2016</b>
		Reference	
<b>NGA/OD/FROM</b>	<b>Ismajl Kurteshi, deputet i Grupit Parlamentar të Lëvizjes</b> <b>VETËVENDOSJE!</b> <i>I Kurteshi</i>		
<b>SUBJEKTI</b> <b>PREDMET</b> <b>SUBJECT</b>	<b>Pyetje Parlamentare (përgjigje me shkrim)</b>		

Në bazë të Rregullës 46 e Rregullores së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigjeje me shkrim:

**ÇËSHTJA:** Monopoli, korrupsioni dhe evazoni fiskal pengojnë Investimet

**PYETJE PARLAMENTARE:** Z. Ministresh, shumë afarist në Kosovë (ata që nuk janë të lidhur me qeveritarët), thonë se pengesë e patejkalueshme për bizneset e tyre është monopoli i krijuar në fusha të ndryshme nga kompanitë të cilat tolerohen nga Qeveria që ta krijojnë dhe ruajnë monopolin si dhe të importojnë mallra pa e paguar doganën.

Terminalet e mallrave, arkat fiskale, homologimi, policat kufitare etj. Këta shembuj dhe shumë të tjerë dëshmojnë ekzistimin e monopolit që po e pengon afarizmin normal në vend.

Këto dukuri negative që po tolerohen nga Qeveria po i pengojnë jo vetëm investimet e huaja por edhe po i detyron bizneset aktive vendore të ikin nga Kosova dhe të investojnë në vende të tjera, si që është rasti i prodhuesit të vetëm të vajit ushqimor të afaristit Konushfci, i cili i ka lënë pa punë 120 punëtor dhe fabrikën e tij e ka hap në Bullgari.

Znj. Ministresh, tani më ka kaluar një vjet që kur e udhëhiqni këtë ministri. Çka keni ndërmarr konkretisht që ta pamundësoni monopolin, korrupsionin dhe evazionin fiskal?





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

ASSEMBLY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
SKUPŠTINA REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
ASSEMBLY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO  
Zyra për Propozime dhe Parashitresa-Kancelarija e Propozimeve dhe Office  
Nr. Prot. 05/1707/D0-892  
Nr. i faqeve 22.02.2016  
Broj stranica  
No. pages:  
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

<b>PËR / ZA / TO</b>	Hashim Thaçi Ministër i Punëve të Jashtme	<b>DATE DATUM DATE</b>	22.02.2016
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Ismajl Kurteshi <i>I. Kurteshi</i> Deputet i Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje Parlamentare (përgjigje me shkrim)		

Në bazë të Rregullës 46 e Rregullores së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigjeje me shkrim:


**ÇËSHTJA:** Kërcënim i protestuesve

**PYETJE PARLAMENTARE:** Z. Ministër, me 17 shkurt thatë se ju bashkë me Kryeministrin i pritnit protestuesit (qytetarët e Kosovës) por jo me kafe, me çka i pritnit protestuesit?





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly



<b>PËR / ZA / TO</b>	<b>Kryeministrin e Kosovës, z. Isa Mustafa</b>	<b>DATE DATUM DATE</b>	<b>22.02.2016</b>
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	<b>Ismajl Kurteshi</b> <i>I. Kurteshi</i> <b>Deputet i Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!</b>		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	<b>Pyetje Parlamentare (përgjigje me shkrim)</b>		

Në bazë të Rregullës 46 e Rregullores së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigjeje me shkrim:

**ÇËSHTJA:** Marrëveshja e 25 gushtit

**PYETJE PARLAMENTARE:** Z. Kryeministër, Ju disa herë keni deklaruar se jeni marr vesh me palën serbe në Bruksel se dokumentet që derivojnë në nga marrëveshja e 25 gushtit do t'i dërgoni në Gjykatën Kushtetuese dhe se aktgjykimi i kushtetueses do të respektohet nga të gjitha palët.


Në Bruksel me 27 janar kryeministri serb Vuçiq tha se nuk e njeh Gjykatën Kushtetuese të Kosovës dhe rrjedhimisht as vendimet e saj.

Në këtë situatë si e shihni zgjidhjen e këti problemi?





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly



<b>PËR / ZA / TO</b>	Z. Skënder Hyseni Ministër i Punëve të Brendshme	<b>DATE DATUM DATE</b>	22.02.2016
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Ismajl Kurteshi <i>I. Kurteshi</i> Deputet i Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje Parlamentare (përgjigje me shkrim)		

Në bazë të Rregullës 46 e Rregullores së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigjeje me shkrim:

**ÇËSHTJA:** Policia po veprojnë pa urdhra me shkrim

**PYETJE PARLAMENTARE:** Z. Ministër, gjatë muajve të fundit jam dëshmitar në shumë raste kur policia e Kosovës vepron (sipas tyre bazuar në urdhrat e eprorëve të tyre gojore) pa pasur urdhëresë apo vendim me shkrim, ashtu si do të duhej të komunikohet brenda institucioneve dhe me palën e tret. Deputetët e Kuvendit të Kosovës arrestohen pa urdhër arrest të shkruar, nuk lejohen me hy në seancën plenare të Kuvendit pa urdhëresë me shkrim. Të njëjtit nxjerrën nga salla e Kuvendit zvarrë gjithashtu pa urdhër me shkrim.

Z. Ministër, a jeni të njoftuar për këtë mënyrë të kundërligjshme të punës së policisë? Nëse jeni të informuar çka keni ndërmarr që policia të mos e shkel ligjin, e që eprorët urdhra t'i japin ashtu si parashihet me ligj.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly

REPUBLIC OF KOSOVO  
KOSOVSKA REPUBLIKA  
ASSEMBLY OF KOSOVO  
Zyra për Propozime dhe Përshkrime Komandante të Kuvendit - Prishtinë Tëbë Office  
Nr. Prot. Prot. No. 05/1710/0-895  
Nr. i faqeve No. pages. 22.02.2016  
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

<b>PËR / ZA / TO</b>	<b>Z. Arsim Bajrami, Ministër i MASHT-it</b>	<b>DATE DATUM DATE</b>	<b>22.02.2016</b>
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	<b>Ismajl Kurteshi</b> <i>I. Kurteshi</i> <b>Deputet i Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!</b>		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	<b>Pyetje Parlamentare (përgjigje me shkrim)</b>		


Në bazë të Rregullës 46 e Rregullores së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigjeje me shkrim:

**ÇËSHTJA:** Tejkalimi i numrit të studentëve të regjistruar

**PYETJE PARLAMENTARE:** Z. Ministër, bazuar në informatat që dëgjohe në opinion, kolegjet private kanë regjistruar numër shumë më të madh të studentëve se numri që e kanë të lejuar.

Z. ministër kërkojmë nga ju që ta verifikoni këtë informatë. Të ma përcjellë informatën zyrtare dhe po ashtu të më njoftoni se çka keni ndërmarr ndaj shkelësve të limiteve të lejuara.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	Z. Hajredin Kuci Ministër i Drejtësisë	<b>DATE DATUM DATE</b>	01.03.2016
		Reference	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Ismajl Kurtoshi <i>I. Kurtoshi</i> Deputet i Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje Parlamentare (përgjigje me shkrim)		

Në bazë të Rregullës 46 e Rregullores së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigjeje me shkrim:

**ÇËSHTJA:** Burgjet e Kosovës.

**PYETJE PARLAMENTARE:** Z. Ministër, Shumica e të burgosurve në Burgjet e Kosovës janë të ri. Atyre gjatë vuajtjes së dënimit nuk u jepet mundësia që të riedukohen, marrin ndonjë zanat ose të punojnë diçka.

Bibliotekat në burgje janë shumë të varfra dhe shumica e librave që janë brenda tyre nuk janë libra që kontribuojnë në edukimin e mirë të tyre. Në burgje mungojnë edukatorët që do të punonin me të burgosurit në baza ditore me plan-programe të menduara mirë. Në burgje nuk ka mundësi që të rinjtë e burgosur të mësojnë ndonjë zanat ose të punojnë diçka që do të ishte në interes të tyre dhe të shtetit. Të burgosurit kur ta kenë vuajtur dënimin dalin me pikëpamjet që kanë hy në burg ose edhe me ndonjë ves të keq që e kanë fituar nga të burgosurit e tjerë.

Z. Ministër, a keni menduar ndonjëherë me ndërmarr diçka në këtë drejtim?